



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 461 Prot.

Tiranë, më 03.042018

VENDIM Nr. 75, datë 20.03.2018

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.4, datë 20.03.2018, pasi shqyrtoi **Projektin kërkimor shkencor "Paleokastra"2018**, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike) drejtues Prof. Dr. Luan Përzhita dhe Prof. Dr. Roberto Perna, Universiteti Maceratës, Itali, paraqitur nga Instituti Arkeologjisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë **Projektin kërkimor shkencor "Paleokastra"2018**, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike) drejtues Prof. Dr. Luan Përzhita dhe Prof. Dr. Roberto Perna, Universiteti Maceratës, Itali, paraqitur nga Instituti Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Rilevim topografik i kështjellës
 - Survey gjeofizik
 - Sondazhe tek porta e Kështjellës
 - Pastrimi dhe rilevimi i Bazilikës brënda mureve rrethuese.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë ajo e nevojshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2018.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al

4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUBINA ZOTO